



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E SHKALLËS SË PARË E JURIDIKSIONIT TË
PËRGJITHSHËM TIRANË

Nr.1312/96/1315 Regj.Them
Data e rregj. 09.03.2022/09.03.2023

NR.1359VENDIMI
Dt.29.05.2023

VENDIM

“NË EMËR TË REPUBLIKËS”

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë me trup gjykues e përbërë nga:

GJYQTARE - VJOLLCA SPAHIU

asistuar prej sekretares gjyqësore **zj.Gentiana Sadiku**, në Tiranë sot më datë **29.05.2023**, përfundoi së gjykuari në seancë gjyqësore publike, me pjesëmarrjen e prokurorit **z. Bledar Valikaj** çështjen penale nr.1312/96/1315akti, që i përket:

KËRKUES:

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, përfaqësuar nga Prokurori **Bledar Valikaj**.

TË PANDEHURIT:

1) **Alban Ujkashej**, i biri i Hasan dhe Shpresa, lindur me 01.08.1969 në Shkodër, banues Rr: "Bujar Bishanaku", pallati nr.1010, shkalla nr.1 Shkodër, me **Cel ;0682031780**, me arsim të lartë, profesioni Menaxher, me kombësi dhe shtetesi shqiptare, me gjendje civile i martuar, me gjendje gjyqësore i padenuar, në mungesë, të përfaqësuar nga avokat **Adriatik Cama** me Nr.10391Licence, Nipt L91512050G,dhe avokat **Sokol Lamaj**, me Nr.2616Licence, Nipt L41403001G Anëtarë të Dhomës së Avokatisë Tiranë. (prokurë e posaçme nr.275rep, nr.136/1kol, datë 16.02.2022.)

AKUZUAR:

Për kryerjen e veprave penale te "Fshehje e te ardhurave" dhe "Falsifikim dokumentash" parashikuar nga neni 180/l dhe 186/2 K.Penal.

2)**Dritan Bylyku**, i biri i Agim dhe i Floresha, lindur me 21.11.1972, ne Tiranë, banues në Tiranë, Rr: "Dibrës", pallati nr.42, shk. Nr.11, ap.nr.50, Tirane, me **Cel ;0684011421**, me arsim të lartë , profesioni Financier,

me kombësi dhe shtetesi shqiptare, me gjendje civile i martuar, me gjendje gjyqesore i padenuar, në mungesë, të përfaqësuar nga avokat **Adriatik Cama** me Nr.10391Licence, Nipt L91512050G,dhe avokat **Sokol Lamaj**, me Nr.2616Licence, Nipt L41403001G Anëtarë të Dhomës së Avokatisë Tiranë. (prokurë e posaçme nr.275rep, nr.136/1kol, datë 16.02.2022.)

AKUZUAR:

Për kryerjen e veprave penale te "Fshehje e te ardhurave" dhe "Falsifikim dokumentash" parashikuar nga neni 180/l dhe 186/2 K.Penal.

3) Ana Zervoi, identifikuar me kartë identiteti me nr.personal ID **J26001114E**, e bija e Astrit dhe e Keti, lindur me 09.10.1988 në Greqi dhe banuese në Tiranë, Rr: "Frosina Plaku", Kompleksi "Magnet", pallati "Auriga", Hyrja nr.2, Ap. 2081, arsim i lartë, juriste, e martuar, e padenuar me pare, kombesi e shtetesi shqiptare,Cel.0684079145, përfaqësuar nga avokat **Adriatik Cama** me Nr.10391Licence, Nipt L91512050G,dhe avokat **Sokol Lamaj**, me Nr.2616Licence, Nipt L41403001G Anëtarë të Dhomës së Avokatisë Tiranë.

AKUZUAR:

Për kryerjen e veprave penale te "Fshehje e te ardhurave" dhe "Falsifikim dokumentash" parashikuar nga neni 180/l dhe 186/2 K.Penal.

4) Roland Joti, identifikuar me kartën e identitetit me nr.personal ID **G10826031G**, i biri i Spiro dhe Poliksen, lindur me 26.08.1961, në Korçë, banues Rr: "Myslym Shyri", pallati nr.2, shk. Nr.0, ap.nr.12, Tirane, me **Cel ;0682036410**, me arsim të lartë, profesioni Financier, me kombësi dhe shtetesi shqiptare, me gjendje civile i martuar, me gjendje gjyqesore i padenuar, në mungesë, përfaqësuar nga avokat **Adriatik Cama** me Nr.10391Licence, Nipt L91512050G,dhe avokat **Sokol Lamaj**, me Nr.2616Licence, Nipt L41403001G Anëtarë të Dhomës së Avokatisë Tiranë.

AKUZUAR:

Për kryerjen e veprave penale te "Fshehje e te ardhurave" dhe "Falsifikim dokumentash" parashikuar nga neni 180/l dhe 186/2 K.Penal.

5)Ylli Shemeti, identifikuar me kartën e identitetit me nr.personal ID **H20116092K**, i biri i Bajram dhe Hava, lindur me 16.02.1974 në Tiranë, banues Rr: "Dritan Hoxha", pallati MC inert, shk. Nr.1, ap.nr.19, Tirane, me

Cel ;0682975433, me arsim të lartë, profesioni Menaxher, me kombësi dhe shtetesi shqiptare, me gjendje civile i martuar, me gjendje gjyqesore i padenuar, në mungesë, përfaqësuar nga avokat **Adriatik Cama** me Nr.10391Licence, Nipt L91512050G,dhe avokat **Sokol Lamaj**, me Nr.2616Licence, Nipt L41403001G Anëtarë të Dhomës së Avokatisë Tiranë.

AKUZUAR:

Për kryerjen e veprave penale të "Fshehje e të ardhurave" dhe "Falsifikim dokumentash" parashikuar nga neni 180/l dhe 186/2 K.Penal.

6) Florent Venediku, i biri i Bashkim dhe Reko, lindur me 31.05.1967 në Selenic, banues Rr: "Durrësit", pallati Nr.12, Tiranë, me **Cel ;0684011420**, me arsim të lartë, profesioni inxhinier, me kombësi dhe shtetesi shqiptare, me gjendje civile i martuar, me gjendje gjyqesore i padenuar, në mungesë, përfaqësuar nga avokat **Adriatik Cama** me Nr.10391Licence, Nipt L91512050G,dhe avokat **Sokol Lamaj**, me Nr.2616Licence, Nipt L41403001G Anëtarë të Dhomës së Avokatisë Tiranë.

AKUZUAR:

Për kryerjen e veprave penale të "Fshehje e të ardhurave" dhe "Falsifikim dokumentash" parashikuar nga neni 180/l dhe 186/2 K.Penal.

7) Subjekti "Inter Distribution Services" shpk, përfaqësuar nga administratore znj.Ervisa Rabdishta, e bija e Hamdi dhe Fatbardha, lindur me 31.05.1984 në Lezhë, banuese Rr: "Ali Demi", pallati nr.1, Shk.nr.1, ap.11, Njësia Bashikake nr.1, 1004, Tiranë, në mungesë, përfaqësuar nga avokat **Adriatik Cama** me Nr.10391Licence, Nipt L91512050G,dhe avokat **Sokol Lamaj**, me Nr.2616Licence, Nipt L41403001G Anëtarë të Dhomës së Avokatisë Tiranë.

AKUZUAR:

Për kryerjen e veprave penale të "Fshehje e të ardhurave" dhe "Falsifikim dokumentash" parashikuar nga neni 180/l dhe 186/2 K.Penal.

8) Subjekti "Inter Trade & Distribution" shpk regjistruar në QKB me Nipt nr. K91524002L, me administratore Dritan Bylyku, në mungesë, përfaqësuar nga avokat **Adriatik Cama** me Nr.10391Licence, Nipt L91512050G,dhe avokat **Sokol Lamaj**, me Nr.2616Licence, Nipt L41403001G Anëtarë të Dhomës së Avokatisë Tiranë.

AKUZUAR:

Për kryerjen e veprave penale të "Fshehje e të ardhurave" dhe "Falsifikim dokumentash" parashikuar nga neni 180/1 dhe 186/2 K.Penal.

IPANDEHUR

9)Eduard Allushi, identifikuar me pasaportë biometrike me nr.personal ID **H80108138L**, i biri i Sehit dhe e Arzie, lindur me 08.01.1978 në Tiranë dhe banues në Tiranë, Rr: "Sitki Cico", pall. nr.4/1, shk.4, ap.88, arsim të mesëm, punonjës i brendshëm tek marketi "Union Market", i martuar, me dy fëmijë, i padënuar me parë, kombesi e shtetesi shqiptare, Cel. 0694530077, përfaqësuar nga av. Napoleon. Llalla, me nr.7182Liçence, Anëtar i Dhomës së Avokatisë Tiranë.

AKUZUAR:

Për kryerjen e veprës penale të "Falsifikim dokumentash" parashikuar nga neni 186/2 K.Penal.

Në përfundim të shqyrtimit gjyqësor, Gjykata, pasi administroi provat shkresore, dëgjoi dhe administroi në fashikull diskutimet përfundimtare të palëve, të cilat përfundimisht kërkuan :

A. Prokurori:

1. Deklarimin fajtor të të pandehurve: Alban Ujkashej, Dritan Bylyku, Ana Zervoi, Roland Joti, Ylli Shemeti, Florent Venediku për kryerjen e veprave penale të : "Fshehja e të ardhurave" dhe "Falsifikimi i dokumentave", të parashikuara dhe të dënueshme nga nenet 180/1 dhe 186/2 të K.Penal dhe dënimin e tyre me nga 6 muaj burgim, për secilën vepër.

- Në aplikim të nenit 55 të Kodit Penal, në bashkim të dënimeve caktimin e një dënimi të vetëm për secilin të pandehur me nga 9 muaj burgim.
- Aplikimin e nenit 406 të K.Pr.Penale, për gjykimin e shkurtuar, dënimin e të pandehurve me nga 6 muaj burgim.
- Bazuar në nenin 59 të K.Penal, pezullimin e ekzekutimit të dënimit me burg për të pandehurit e mësipërm dhe vënien në provë për një periudhë 12 mujore, si edhe detyrimin për pagimin e shpenzimeve procedurale.

2. Deklarimin fajtor të subjekteve : "Inter Trade & Distribution" shpk dhe "Inter Distribution Services" shpk, për kryerjen e veprave penale të : "Fshehja e të ardhurave" dhe "Falsifikimi i dokumentave", të parashikuara dhe të dënueshme nga nenet 180/1 dhe 186/2 të K.Penal dhe dënimin e tyre respektivisht me nga 600 mijë lekë gjobë.

- Në aplikim të nenit 55 të Kodit Penal, në bashkim të dënimeve, caktimin e një dënimi të vetëm për secilin të pandehur me nga 900 mije lekë gjobë.
- Aplikimin e nenit 406 të K.Pr.Penale, për gjykimin e shkurtuar, dënimin e të pandehurve me nga 600.000 lekë gjobë.

3. Deklarimin fajtor të të pandehurit Eduard Allushi, për kryerjen e veprës penale të "Falsifikimi i dokumentave", e parashikuar dhe e dënueshme nga neni 186/2 i K.Penal, dhe dënimin e tij me 6 muaj burgim.

- Në aplikim të nenit 406 të K.Pr.Penale dënimin e tij me 4 muaj burgim.
- Bazuar në nenin 59 të K.Penal pezullimin e ekzekutimit të dënimit me burgim dhe vënien në pronë për një periudhë prej 8 muajsh.

B. Përfaqësuesit e të pandehurve : Alban Ujkashej, Dritan Bylyku, Ana Zervoi, Roland Joti, Ylli Shemeti, Florent Venediku, Eduard Alushi, "Inter Trade & Distribution" shpk dhe "Inter Distribution Services" të cilët kërkuan:

- Deklarimin e pafajshëm

C. **Të pandehurit**, që konfirmuan qëndrimin e përfaqësuesve të tyre ligjorë;

Si edhe analizoi e shqyrtoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N :

1. Se, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me juridiksion të përgjithshëm ka sjellë për gjykim çështjen penale nr. 828, të vitit 2020, regjistruar për veprat penale të : “Fshehja e të ardhurave” dhe “Falsifikimi i dokumentave”, të parashikuara dhe të dënueshme nga nenet 180/1 dhe 186/2 të Kodit Penal, në ngarkim të shtetasve : Alban Ujkashej, Dritan Bylyku, Ana Zervoi, Roland Joti, Ylli Shemeti, Florent Venediku, Eduard Allushi, si edhe subjekteve tregtare : “Inter Distribution Services” shpk dhe “Inter Trade & Distribution” shpk.

2. Gjykata pasi studioji materialet e çështjes penale të paraqitur për gjykim, bazuar në nenin 69 të K.Pr.Penale, çmoi se çështja është në juridiksionin e saj dhe gjykimi duhet të realizohet para kësaj gjykate, si kompetente në tokë dhe lëndë, në mbështetje të neneve 13, 74 dhe 76 të K.Pr.Penale. Gjithashtu nga palët në gjykim, nuk pati kërkesa dhe as u verifikuan kryesisht arsye moskompetence.

2.1. Në vështrim të neneve 13, 15-18, të K.Pr.Penale, gjykata çmoi se nuk ekzistojnë shkaqe papajtueshmërie ose përjashtimi nga ky gjykim, ndërkohë që edhe nga palët nuk u pretendua dhe as u ngrit ndonjë kundërshtim pasi u prezantua përbërja e trupit gjykues dhe sekretaria gjyqësore.

3. Në seancë gjyqësore nga ana e të pandehurve dhe mbrojtësve të tyre, u kërkua aplikimi i gjykimit të shkurtuar, në bazë të nenit 403 të K.Pr.Penale. Pasi u tërhoq edhe mendimi i prokurorit, në bazë të nenit 405 të K.Pr.Penale dhe Vendimit Unifikues nr. 2, datë 29.01.2003 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, Gjykata çmoi se kërkesa është e bazuar në ligj dhe si e tillë duhet pranuar. Nuk verifikohet asnjë rrethanë për mospranimin e kërkesës, nuk u pretendua nga palët pavlefshmëri aktesh apo papërdorshmëri provash dhe çështja mund të zgjidhet në gjendjen në të cilën gjenden aktet.

3.1. Në bazë të ritit të gjykimit të shkurtuar, dosja e prokurorit kthehet në dosje gjyqësore dhe si e tillë, palët ftohen të parashtrijnë qëndrimet përfundimtare¹

I. Rrethanat e faktit :

4. Nga ana e organit të akuzës në lidhje me këtë procedim penal, janë parashtruar rrethanat e faktit si më poshtë :

4.1. Nga Sektori i Hetimit Tatimor, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, janë kryer verifikime dhe hetime në lidhje me respektimin e legjislacionit tatimor nga ana e subjekteve tregtare “Inter Distribution Services” shpk me Nipt K71612801P (më poshtë IDS Shpk) dhe “Inter Trade & Distribution” shpk me Nipt K91524002L (më poshtë ITD Shpk). Në bazë të informacioneve të marra dhe administruara nga administrata tatimore, janë ngritur dyshime në

¹ Vendimi Unifikues nr. 2/2003 i KBGJL, ka nxjerrë sentencën se “Me pranimin e kërkesës për të vazhduar me gjykim të shkurtuar, dosja e prokurorit kthehet në dosje gjyqësore dhe shërben për t’u bazuar në parashtrimin e konkluzioneve përfundimtare të palëve dhe për dhënien e vendimit nga gjykata...”

bazë të të cilave këto subjekte, mund të kenë kryer veprime fiktive të faturimit të mallrave, përkundrejt subjekteve të tjera të rezultuara me status 'pasiv' apo të 'ç'regjistruar', të cilat nuk i përgjigjen realitetit.

4.2. Fillimisht në Drejtorinë e Hetimit Tatimor, pranë DPT-së, me shkresën nr. 8213 prot, datë 13.11.2018 është administruar materiali, nga analizimi i të cilit rezulton se Sektori i Mbledhjes dhe Informacionit, Rajoni Qëndror ka nisur një hetim parësor administrativ për subjektin IDS shpk, pasi me shkresën nr. 18515 prot, datë 03.06.2016 ardhur nga Drejtoria e Menaxhimit të Riskut, pranë DPT-së, ky subjekt ka kryer shitje në favor të subjekteve që sipas QKB-së dhe sistemit informatik tatimor C@ts, rezultojnë me status 'Pasiv', 'Kërkesë për ç'regjistrim' ose të 'ç'regjistruar'.

5. Përpos këtij konstatimi, me Shkresën nr. 32951 prot, datë 16.11.2016, nga ana e policisë gjyqësore të Sektorit të Hetimit Tatimor, u morr dijeni në lidhje me materialin e Sektorit të Mbledhjes dhe Informacionit, ku është verifikuar ankesa e shtetases Lindita Spaho, e cila si përfaqësuese e Subjektit "Lindita Spaho" pf, me nipt nr. L32217044L, pretendon se subjekti IDS shpk i ka ngarkuar fiktivisht blerje, përkatësisht për vitin 2015, në vlerën prej 6.800.000 lekë si dhe për vitin 2016 në vlerën 733,732 lekë. Ndërkohë që ndryshe nga sa është faturuar, ankuesja ka deklaruar se nga subjekti IDS shpk, ka blerë produkte në periudhën 2015 - 2016 në vlerën totale prej 418.810 lekë, përkundrejt 549 faturave tatimore.

5.1. Në lidhje me këtë situatë, nga ana e shërbimeve Task-Force pranë DPT-së, janë kryer kontrole pranë IDS Shpk duke u administruar librat e shitjes dhe kopje e faturave të lëshuara nga ky subjekt, përkundrejt subjektit 'Lindita Spaho' pf. Nga analiza e kryer nga administrata tatimore, faturat e dyshuara të parregullta i përkasin periudhës Janar 2015 - Maj 2016.

6. Krahas dokumentacionit fiskal të administruar nga subjekti IDS shpk, me shkresën nr. 19843 prot, datë 28.10.2019, administrata tatimore i ka kërkuar të vendoset në dispozicion të strukturave të hetimit edhe faturat tatimore të lëshuara për subjektet me status të pezulluar/ç'regjistruar, nga ana e subjektit ITD Shpk. Në kthim përgjigje me shkresën nr. 85 prot, datë 31.10.2019, janë vendosur në dispozicion aktet e kërkuara sipas listës bashkëlidhur saj.

7. Në lidhje me lëshimin e këtyre faturave nga subjektet IDS shpk dhe ITD shpk përkundrejt subjekteve me status 'pasiv', 'kërkesë për ç'regjistrim' dhe 'ç'regjistruar', janë marrë deklarime nga ana e të pandehurës Ana Zervoi, e cila në cilësinë e administratorit të shoqërisë ITD shpk dhe IDS shpk, ka deklaruar se, prej datës 01.05.2019 bashkë/administron me administratorët tregtarë Dritan Bylyku (b/administrator të subjektit ITD shpk) dhe Lert Vojka (b/administratorë të subjektit IDS shpk) subjektet IDS dhe ITD shpk. Në lidhje me lëshimin e faturave për disa subjekte që janë me status pasiv/çregjistruar, ajo deklaroi se, subjektet nuk janë bërë të njohura në asnjë nga faqet zyrtare ku publikohet informacion, lidhur me statusin e tatimpaguesve. Mbi faturat e lëshuara tek 'Lindita Spaho' pf, për periudhën 06.01.2015 - 31.05.2016, e pandehura deklaroi se, ato janë kryer nga ish-punëmarrësi i shoqërisë Eduart Allushi dhe në dijeninë e saj janë nënshkruar rregullisht si nga pala blerëse ashtu edhe nga Eduarti.

7.1. Janë marrë deklarime nga ana e shtetasit Eduart Alushi, i cili deklaroi se ka punuar në subjektin IDS shpk, në pozicionin e shitësit si agjent *derë më derë*, duke shkuar tek çdo subjekt që kërkonte furnizim dhe mbulonte përgjithësisht zonat jashtë unazës së Tiranës. I pandehuri deklaroi se, faturat lëshoheshin përmes një sistemi të automatizuar me klientët dhe e prisnin faturën në momentin që kryenin shitjen dhe bëhej pagesa. Volumi i shitjeve ka qenë rreth 35 fatura në ditë.

Në lidhje me faturat e lëshuara ndaj Lindita Spaho, ka deklaruar se ato janë lëshuar pa ndonjë qëllim të keq, pasi tregëtimi i cigareve është pa Tvsh dhe nuk e ka menduar që mund të dalin probleme nga ky veprim.

7.2. Në deklaratimet e marra, shtetasja Lindita Spaho, ka deklaruar se, me subjektin IDS shpk kemi patur dhe kemi marrëdhënie të furnizimit me cigare. Nuk kemi pasur probleme deri në momentin që na ka ardhur një shkresë nga DRT Tiranë, e cila njofton ndryshimin e përgjegjësisë tatimore. Sipas kësaj shkrese rezultoi se subjekti kishte blerje në vlerë rreth 7.2 mln lekë, gjë e cila nga verifikimet nuk ka qenë e vërtetë. Mbi këtë fakt - deklaruesja shpjegon se - është ballfaqyer me personin që bënte furnizimin Eduart Allushi, por ai nuk i ka dhënë përgjigje. Duke mos marrë përgjigje nga personi dhe as nga firma, deklaruesja ka paraqitur ankesë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

8. Nga ana e prokurorisë janë administruar faturat e lëshuara ndaj subjektit 'Lindita Spaho' pf, për të cilat është urdhëruar kryerja e ekspertimit grafik të shkrimit. Në përgjigje me shkresën nr. 2780, datë 12.02.2021 është dhënë akti i ekspertimit nga policia shkencore, në konkluzion të të cilit thuhet se : Shkrimet emër mbiemër sipas rastit të paraqitjes së tyre apo nënshkrimet përkatëse të tyre, objekte të drejtëpërdrejta ekspertimi, të ndodhura nën rekuizitën 'blerësi' të 163 faturave tatimore të lëshuara nga IDS me nipt L32217044L, paraqesin karaktere relativisht të mjaftueshme për krahasim. Në lidhje me aktin e ekspertimit rezultoi se disa fatura nuk janë nënshkruar nga shtetasja Lindita Spaho.

9. Përsa i përket dëmit të shkaktuar, Prokuroria ka nxjerrë vendimin për kryerjen e ekspertimit kontabël, duke i caktuar ekspertit detyrat si më poshtë:

1. *Subjektet IDS shpk dhe ITD shpk nëpërmjet raportimit të katër faturave objekt hetimi a ka kryer fshehje të të ardhurave?*

2. *Nëpërmjet raportimit të katër faturave objekt hetimi, a ka përfituar ekonomikisht në mënyrë fiktive apo rimbursimi të Tvsh-së?;*

3. *Faturat e lëshuara nga subjektet, a kanë respektuar kërkesat e ligjit nr. 9920/2008 "Për procedurat tatimore në RSH? Sa janë në total këto fatura dhe sa është vlera e tyre?;*

4. *Për faturat e shitjes të bëra nga subjektet me status 'Pasiv', 'Kërkesë për ç'regjistrim'; dhe "ç'rregjistruar' të bëra nga subjektet IDS dhe ITD shpk, cila është vlera e Tvsh së kredituar nga këto subjekte dhe a janë bërë shitje këto shitje/blerje sipas ligjit nr. 9920/2008 "Për procedurat tatimore në RSH?;*

5. *Nëse ka fshehje të të ardhurave, sa janë ato të ndara në vite, sa është shumatorja e tyre, sa është detyrimi i shmangur?*

9.1. Në përgjigje të pyetjeve të ngritura gjatë fazës së hetimeve paraprake, eksperti ka dhënë aktin e ekspertimit kontabël, në të cilin pyetjeve të ngritura ju është dhënë përgjigje si më poshtë :

1. Subjektet IDS shpk dhe ITD shpk në aktivitetin e tyre nëpërmjet raportimit të katër faturave, me blerës subjekte me status 'pasiv', 'kërkesë për ç'regjistrim' dhe "ç'rregjistruar', janë në shkelje të ligjit nr. 9920/2008, sepse momenti i lëshimit të faturës tatimore, rregullohet nga neni 51 i ligjit nr. 9920/2008 me titull 'Lëshimi i faturës tatimore', i cili parashikon se : "1. Shitësi lëshon faturë tatimore dhe blerësi duhet ta kërkojë atë në kohën e realizimit të shitjes apo të kryerjes së punimit ose shërbimit. Fatura tatimore përkatëse nga shitësi jo më pak se dy kopje, nga të cilat njërin e merr dhe e ruan blerësi, kurse tjetrën e mban dhe e ruan shitësi". Në zbatim të nenit 54, pika 5 të Ligjit nr.

9920/2008, të gjitha këto fatura që shoqëria ka kryer në këto subjekte duhet të rivlerësohen pasi konsiderohen si shitje me pakicë, meqë janë për konsumatorin përfundimtar.

2. Në përgjigje të pyetjes 2, duke ju referuar *sheet* ‘blerje’, subjektet IDS dhe ITD shpk, kanë blerje (nga subjekte pasive/çregjistruar) për të cilat ju lind tatim fitimi në shumat : IDS : 178.781 lekë dhe ITD : 7.275 lekë;
Duke ju referuar *sheet* ‘shitës’, subjektet në hetim kanë shitje (për subjekte pasivë/çregjistruar) në volumet që ju lindin detyrime tatim fitimi në shumat : për IDS në Total = 4.981.938 lekë dhe ITD në total = 594.366 lekë;
3. Në përgjigje të pyetjes 3, Subjektet IDS dhe ITD shpk, kanë lëshuar fatura për subjekte me status pasiv dhe ç’regjistruar, duke qenë në kushtet e lëshimit të parregullt të këtyre faturave.
4. Në lidhje me pyetjen nr. 4, përsa i përket furnizimeve me produktin ‘cigare’ Tvsh për to paguhet tërësisht nga ‘furnizuesi kryesor’, për çdo furnizim të kryer. Pra, vlera e tatueshme e çdo furnizimi, të kryer nga furnizuesi për të tretët, përsaktohet si produkt i cigareve të shitura, me çmimin e shitjes me pakicë, pa përfshirë TVSH-në. Ndërsa për produktet e tjera që i përkasin subjektit ITD shpk, është vlera e mallit të shitur pa tvsh duke aplikuar një marzh fitimi 10 % dhe Tvsh 20 % vlera do të jetë 339.638 lekë.
5. Në lidhje me pyetjen nr. 5, eksperti konkludon se, jemi në kushtet e lëshimit të parregullt të këtyre faturave, nga të cilat sipas Akt Vlerësimit Kontavbël të ndara në vitet 2015 – 2020, rezultojnë shumat e tatimit sipas rezultateve të pikës ‘2’ më sipër.

10. Nga ana e organit të akuzës, janë administruar librat e shitjes së deklaruara nga ana e subjekteve IDS shpk dhe ITD Shpk, të cilat të ndara sipas numrave të serialeve, janë të relatuar në tabelat përkatëse (referuar aktit të ekspertimit dhe konkluzioneve të prokurorit).

10.1. Duke konkluduar se, nga ana e administratorëve të subjeteve IDS shpk dhe ITD shpk, për periudhën 2015 - 2020, në bashkëpunim edhe me subjektet tregtare, janë kryer veprime aktive, me qëllim shmangien e detyrimit tatimor në favor të organeve tatimore, duke u përdorur fatura të parregullta, organi i prokurorisë, ju ka njoftuar akuzat dhe ka marrë të pandehur personat dhe subjektet sipas relatimit të bërë në pjesën hyrëse të këtij vendimi. Mbi këto akuza, ka sjellë për gjykimin në tërësi procedimin penal, duke kërkuar deklarinim fajtor të të pandehurve, për rrethanat e mësipërme mbi të cilat janë ngritur akuzat e “Fshehja e të ardhurave” dhe “Falsifikimi i dokumentave” të parashikuara nga nenet 180/1 dhe 186/2 të K.Penal.

11. Në konkluzionet e tyre, mbrojtësit e të pandehurve kanë kërkuar deklarinim e pafajshëm të tyre, duke arsyetuar - në mënyrë të përmbledhur, pasi pretendimet e detajuara ndodhen në diskutimet përfundimtare të palëve pjesë e fashikulit të gjykimit - se :

Së pari: Vepra penale e pretenduar nga prokuroria është e parashkuar për shkak të kalimit të afatit ligjor nga fakti penal i pretenduar, e deri në marrjen e personave të pandehur, ka kaluar më tepër sesa 5 vite;

Së dyti : Veprimet e kryera nga Eduart Alushi si punonjës i subjektit IDS shpk në faturimin ndaj Lindita Spaho pf, nuk i kanë sjellë asnjë dobi shoqërisë dhe si të tilla, janë veprime individuale të personit;

Së treti : Ligji për procedurat tatimore, e parashikon si shkelje lëshimin e faturave tatimore përkundrejt subjekteve me status pasiv, vetëm me ndryshimet e bëra në vitin 2019. Të gjitha masat

që ishin marrë ndaj subjekteve në lidhje me lëshimin e faturave të tilla, janë gjetur të paligjshme dhe janë shfuqizuar në të gjitha rastet nga Drejtoria e Apelitit Tatimor (referuar diskutimeve dhe vendimeve të DAT, pjesë e fashikullit të gjykimit).

Në përfundim, të pandehurit, kërkuar pafajsi.

II. Vlerësimi dhe arsyetimi ligjor i Gjykatës :

12. Nga shqyrtimi gjyqësor ka rezultuar e provuar se, Subjekti IDS shpk është shoqëri e të drejtës shqiptare, e themeluar më datë 21.03.2007 dhe rregjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit më datë 05.04.2007, duke u pajisur me Nipt nr. K71612801P. Subjekti rezulton me status aktiv dhe objekt të aktivitetit ka: *"Importim, eksportim dhe tregtim me shumicë dhe pakicë të produkteve dhe artikujve të ndryshëm ushqimorë, cigareve, pijeve, të higjenës personave, kozmetike...."*

Për periudhat 2015 - 2020, ky subjekt ka patur administratorë dhe b/administratorë respektivisht të pandehurit :

- Alban Ujkashej;
- Roland Joti;
- Ana Zervoi;
- Ylli Shemeti;

12.1. Nga hetimet e kryera nga organi i akuzës ka rezultuar se subjekti IDS shpk ka deklaruar në administratën tatimore librat e shitjes, për të cilat nga hetimi rezultojnë fatura të lëshuara ndaj subjekteve me status 'pasiv', 'kërkesë për çrregjistrim' dhe 'çrregjistruar', të cilat kanë një vlerë totale prej 434.379.917 lekë.

13. Nga ana tjetër, Subjekti ITD shpk, është shoqëri tregtare e të drejtës shqiptare, e themeluar më 10.03.2009 dhe rregjistruar në QKB më datë 24.03.2009, duke u pajisur me Nipt nr. K91524002L. Subjekti rezulton me status aktiv dhe objekt të aktivitetit të saj ka : *"Importim, eksportim dhe tregtim me shumicë dhe pakicë të produkteve dhe artikujve të ndryshëm ushqimorë, cigare, pijeve të higjenës personale...."*

Për periudhat 2015 - 2020, ky subjekt ka patur administartor dhe bashkëadministrator, respektivisht të pandehurit :

- Florent Venetiku;
- Roland Joti;
- Dritan Bylyku;
- Ana Zervoi;

13.1. Nga hetimet e kryera nga organi i akuzës ka rezultuar se subjekti IDS shpk ka deklaruar në administratën tatimore librat e shitjes, për të cilat rezultojnë fatura të lëshuara ndaj subjekteve me status 'pasiv', 'kërkesë për çrregjistrim' dhe 'çrregjistruar', që kanë një vlerë totale prej 16.981.880 lekë;

Në bazë të legjislacionit tatimor, shitja e produkteve 'cigare', në bazë të përmbajtjes së vlerave që këto mallra kanë sipas faturave, passjellin një përgjegjësi tatim fitimi repektivisht për subjektin IDS shpk në shumën 4.904.290 lekë dhe ITD shpk në shumën 594.366 lekë.

14. Për t'i bërë një kualifikim të drejtë ligjor, sjelljeve të konstatuara të kryera nga ana e të pandehurve pjesë e procedimit penal nr. 828, të vitit 2020, Gjykata çmon që fillimisht të ngrejë tri çështje ligjore për trajtim, e në konkluzion të tyre, të shprehet mbi zgjidhjen përfundimtare të çështjes.

Çështjet ligjore të nevojshme për t'u ngritur dhe trajtuar, me qëllim dhënien e zgjidhjes së drejtë dhe të bazuar në ligj të rastit janë:

- A. Lëshimi i faturave tatimore përkundrejt subjekteve me status 'pasiv', 'kërkesë për çrregjistrim' dhe/ose 'çrregjistruar', cilat dispozita të legjislacionit tatimor cënojnë, dhe a sjellin këto veprime konfigurim të elementëve të veprës penale të "Fshehja e të ardhurave", e parashikuar nga neni 180 i K.Penal në rastin konkret?
- B. Pasaktësitë e konstatuara në faturat e lëshuara nga ana e subjekteve tregëtare IDS dhe ITD shpk, a përmbushin elementët e veprës penale të falsifikimi i dokumentave, të parashikuar nga neni 186 i K.Penal?
- C. Faturat tatimore të falsifikuara, të konstatuara nga akti i ekspertimit grafik shkrimi, cilës periudhë i përkasin dhe si qëndron raporti i tyre me nenin 66 të K.Penal?

15. Në lidhje me çështjen e parë të shtruar për analizë, Gjykata çmon se, në bazë të verifikimeve të kryera fillimisht nga administrata tatimore e më pas nga hetimet e prokurorisë, ka rezultuar se, subjektet IDS dhe ITD shpk, kanë kryer shitje përkundrejt subjekteve me status pezulluar/çrregjistruar për periudhën 2015 -2020, në volumet dhe vlerat në lek, si më poshtë :

IDS shpk

Vitet ; 2015 = 272,678,438
 2016 = 90.797.705;
 2017 = 48.686.130;
 2018 = 10.756.704;
 2019 = 5.933.964;
 2020 = 5.526.976;

ITD shpk

Vitet : 2015 = 11.384.089;
 2016 = 3.505.665;
 2017 = 1.413.893;
 2018 = 280.990 ;
 2019 = 226.328;
 2020 = 170.915;

15.1. Në bazë të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore", (i ndryshuar), në fuqi deri në fund të vitit 2019, në Nenin 51, të tij "Lëshimi i faturës tatimore", parashikonte se : "Shitësi lëshon faturë tatimore dhe blerësi duhet ta kërkojë atë në kohën e realizimit të shitjes apo të kryerjes së punimit ose shërbimit. Fatura tatimore përgatitet nga shitësi në jo më pak se dy kopje, nga të cilat njërën e merr dhe e ruan blerësi, kurse tjetrën e mban dhe e ruan shitësi. Faturat përgatiten me numër rendor progresiv...". Në rastin e shkeljes së detyrimeve mbi këtë përcaktim, pika 2 e nenit 51, parashikonte sanksione administrative sipas nenit 121² të Ligjit nr. 992/2008.

15.2. Ndërkohë me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 83/2019 "Për disa shtesa në ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në RSH", botuar në Fletoren Zyrtare nr. 184, datë 31.12.2019, në nenin 5 të tij parashkohet se: "Nenet 48, 50, 51, 52, 53, 54, 55 dhe 56 shfuqizohen". Suprimimet e dispozitave të mësipërme ligjore, u shoqëruan me futjen në fuqi të paketës fiskale të vitit 2020, si pjesë e të cilës edhe Ligji nr. 87/2019 "Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit", botuar në Fletoren Zyrtare nr. 3, datë 20.01.2020, i cili tashmë përcaktonte të detyrueshme lëshimin e faturës elektronike dhe pranimin e saj nga blerësi³. Me miratimin e ligjit të mësipërm, sistemi elektronik i krijuar, verifikon automatikisht statusin e subjektit blerës, pa nevojën e verifikimeve në faqe publike, duke pamundësuar në këtë mënyrë faturime përkundrejt subjekteve që nuk janë aktivë. Për rrjedhojë, nuk krijohen më diskutime dhe as ngrihen dyshime, mbi mundësinë e lëshimit të faturave, përkundrejt subjekteve me status 'pasiv', 'kërkesë për çrregjistrim' dhe/ose 'çrregjistruar'.

² Neni 51, i Ligjit nr. 9920/2008 "Për procedurat tatimore", deri para ndryshimeve të v. 2019, formulohej i tillë "Tatimpaguesi që mban në ruajtje, përdor apo transporton mallra të pashoqëruara me dokumente tatimore, dënohet, në përputhje me nenin 121 të këtij ligji"

³ Neni 3, gërma "d" e Ligjit 87/2019, parashikon "Lëshuesi i detyrueshëm i një fature elektronike është personi i cili sipas këtij ligji, është i detyruar të lëshojë faturë elektronike".

15.3. Një parashikim tjetër ligjor, që i referohet transaksioneve ndërmjet subjekteve me status pasiv, gjendet në nenin 44 të Ligjit nr. 9920/2008 nën titullin “Kalimi në regjistrin pasiv”, i cili në pikën ‘7’ deri para ndryshimeve të vitit 2018 parashikonte se: *“Administrata tatimore qendrore publikon në faqen zyrtare të internetit të DPT dhe mban të përdtësuar listën e tatimpaguesve që janë në regjistrin pasiv. Çdo transaksion i kryer nga tatimpaguesit, persona fizikë apo juridikë, tregëtarë që janë në regjistrin pasiv, konsiderohen shkelje administrative dhe dënohet në përputhje me këtë ligj (ndryshuar me ligj nr. 164/2014, datë 04.12.2014). Ndërkohë që me riformulimin e kësaj pike me Ligjin nr. 97/2018, datë 03.12.2018, pika ‘7’, morri përmbajtjen :* *“Çdo transaksion i kryer nga tatimpaguesit aktivë, persona fizikë apo juridikë, tregëtarë, që me tatimpagues që janë në regjistrin pasiv, konsiderohet shkelje administrative dhe dënohet si më poshtë :*

c) shitësi aktiv në përputhje me pikën 2, të nenit 128 të këtij ligji.
c) blerësi me regjistrim pasiv, me vlerësim tatimor të detyrimit dhe dënim, në përputhje me nenin 116 të këtij ligji;

16. Për t’u rikthyer në lidhje me diskutimin e pjesës së parë të çështjes ligjore “A”, konkludohet se, legjislacioni i posaçëm tatimor, rasteve të lëshimit të faturës tatimore përkundrejt subjekteve joaktivë, ju sanksionon dënime administrative sipas ligjit për procedurat tatimore dhe nuk bën referime të posaçme, në dispozita të caktuara të Kodit Penal, përfshirë edhe dispozitat që ju referohen krimeve në fushën e tatimeve.

17. Megjithatë, gjykata çmon se, - pavarësisht sanksioneve administrative që ligji ju njuh pasaktësive të faturave të lëshuara nga subjektet e paditura - do të bëhet një analizë përsa i përket faktit nëse veprimet dhe mosveprimet e të pandehurve, a formësojnë elementët e veprës penale të “Fshehja e të ardhurave” të parashikuar nga neni 180 i K.Penal.

17.1. Neni 180 i K.penal “Fshehja e të ardhurave”, përcakton se : *“Fshehja apo shmangia nga pagimi i detyrimeve tatimore, nëpërmjet mosdorëzimit të dokumentave ose mosdeklarimit të të dhënave të nevojshme, sipas legjislacionit në fuqi, dorëzimi i dokumentave të falsifikuara, apo deklaratave ose informacioneve të rreme, me qëllim fitimin material, për vete apo për të tjerët, përmes përlllogaritjes së pasaktë të shumës së tatimit, taksës apo kontributit, përbën vepër penale dhe dënohet me burgim deri në tre vjet...”*

Objekti i veprës penale të fshehja e të ardhurave, janë marrëdhëniet juridike të mbrojtura posaçërisht nga legjislacioni penal, nga veprimeve të kundërligjshme, ndaj mirëfunksionimit të veprimtarisë së organeve tatimore.

Nga ana objektive, kjo vepër kryhet përmes mosdorëzimit të dokumentave ose të dhënave të nevojshme, dorëzimit të dokumentave të falsifikuara, apo deklaratave apo informacioneve të rreme.

Subjekt, është çdo individ që ka mbushur moshën për përgjegjësi penale dhe është i përgjegjshëm para ligjit.

Nga ana subjektive, kjo vepër konsumohet vetëm me dashje dhe me qëllim të posaçëm, për të përfituar materialisht për vete apo të tjerë, nga përlllogaritja e pasaktë e shumës së tatimit, taksës apo kontributit.

17.2. Kjo vepër penale kërkon që veprimet sikurse janë : mosdorëzimi i dokumentave, mosdeklarimi i të dhënave të nevojshme, dorëzimi i dokumentave të falsifikuara apo deklaratave ose informacioneve të rreme, duhet që subjektivisht të motivohen nga një qëllim, për të fshehur apo shmangur pagimin e një detyrimi tatimor, për vete apo për një të tretë. Në këto kushte, lëshimi i një fature ndaj një subjekti tregëtar, pavarësisht se joaktiv në organet tatimore apo QKB, jo-

rrjedhimisht sjell konsum të kësaj vepre penale, përse kohë që nuk del i provuar qëllimi i shmangies apo fshehja nga pagimi i detyrimeve tatimore. Sikurse ka rezultuar nga hetimi i organit të akuzës, informacionet në lidhje me faturat e lëshuara përgjatë viteve 2015 - 2020, nga subjektet IDS dhe ITD shpk, kanë qenë të rregjistruara rregullisht në librat fiskalë të administruar nga këto subjekte dhe të dhënat mbi faturat sipas numrave serialë të tyre, kanë qenë të deklaruara në sistemet e administratës tatimore. Në këto kushte rezulton se, nuk ndodhemi përpara rastit të mosdeklarimit apo mosdorëzimit të dokumentacionit apo të të dhënave të nevojshme për përlllogaritjen e detyrimit tatimor, si një nga format e konsumimit të kësaj vepre penale.

18. Duke mos gjetur të meta në lidhje me rregjistrimin dhe deklarimin e faturave tatimore nga subjektet e pandehura, gjykata çmon të analizojë faktin nëse vetëm ekzistenca formale e mosverifikimit të statusit të blerësit, përbën rrethanë të mjaftueshme për të konsideruar të konsumuar anën subjektive të veprës penale të “Fshehja e të ardhurave” parashikuar nga neni 180 i K.Penal, nga ana e të pandehurve.

18.1. Për t'i dhënë përgjigje një rrethane të tillë, pasaktësia në faturat e lëshuara nga ana e subjekteve të pandehura, duhet të jetë shoqëruar detyrimisht nga prezenca e tre situatave ligjore dhe faktike : së pari, duhet që të pandehurit të kenë patur dijeni efektivisht në bazë të një detyrimi ligjor për statusin joaktiv të blerësve; së dyti, duhet që blerësit, jo vetëm juridikisht të kenë rezultuar *joaktivë* por edhe faktikisht veprimtaria e tyre të ketë qenë e mbyllur; dhe së treti : provueshmëria në drejtim të shmangies që e gjithë kjo veprimtari do të sillte në favor të subjekteve të pandehura.

18.2. Në lidhje me rrethanën e parë, gjykata vlerëson të mbajë në konsideratë rregullimet ligjore që i janë referuar ndër viteve detyrimit të verifikimit të statuseve juridike të subjekteve blerëse. Fillimisht Ligji nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në RSH”, në nenin 44 të tij “Kalimi në regjistrin pasiv”, në lidhje me statutet e subjekteve parashikonte se : “6. Të gjithë tatimpaguesit, që rezultojnë mosdeklarues për më shumë se 5 vite kalendarike, duke filluar nga muaji janar i vitit pasardhës të vitit në të cilin tatimpaguesi është mosdeklarues, transferohen automatikisht nga regjistri aktiv në regjistrin pasiv”. (ndryshuar me ligjin nr. 10415, datë 07.04.2011, botuar në FZ nr. 51, datë 03.05.2011).

Me ndryshimet ligjore që ju bënë nenit 44, të Ligjit për procedurat tatimore, detyrimi mbi dijeninë e subjekteve me status pasiv, u bë në pikën 7 të tij, duke u formuluar më përmbajtjen: “Administrata tatimore qëndrore publikon në faqen zyrtare të internetit të DPT dhe mban të përditësuar listën e tatimpaguesve që janë në regjistrin pasiv. Çdo transaksion i kryer nga tatimpaguesit, persona fizikë apo juridikë, tregëtarë që janë në regjistrin pasiv, konsiderohen shkelje administrative dhe dënohet në përputhje me këtë ligj (ndryshuar me ligj nr. 164/2014, datë 04.12.2014).

Ndërsa ndryshimi më i fundit i nenit 44/7, u soll me ligjin nr. 97/2018⁴, i cili e riformulon dispozitën duke e paraqitur me përmbajtjen: “Administrata qëndrore publikon në faqen zyrtare të

⁴ Edhe Ligji nr. 97/2018, qw riformuloi nenin 44/7 tw Ligji “Pwr procedurat tatimore nw RSH”, si sanksion karrshi parregullsive nw deklarimin e statuseve tw subjekteve parashikonte : sanksion e masës së gjobës ndaj subjektit shitës konform përcaktimeve të nenit 44, pika 7, ‘c’ në lidhje me nenin 128, pika 2, të Ligjit nr. 9920/2008. Ndërkohë që referimi në nenin 116 të Ligjit për procedurat tatimore “Evazioni fiskal”, përbën një sanksion që sipas pikës 44, pika 7, gërma ‘ç’, i kundrejtohet blerësit joaktiv, që kryhen një transaksion. Në rastin konkret, subjektet tregtare të pandehura, kanë rezultuar si shitëse aktive, që kanë lëshuar faturë, në favor të subjekteve blerëse jo-aktive.

internetit të DPT dhe përditëson mbi baza ditore listën e tatimpaguesve që janë në regjistrin pasiv...”

Përfundimisht me ligjin nr. 87/2019 “Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit”, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 3, datë 20.01.2020, publikimi manualisht në faqen e DPT-së për efekt të lëshimit të faturave tatimore, u shmang me aplikimin e sistemit të fiskalizimit. Përmes këtij të fundit, statusi *joaktiv* i subjektit blerës, konstatohet në mënyrë automatike nga ana e sistemit dhe pamundëson çdo mundësi për të lëshuar një faturë përkundrejt këtij të fundit.

18.3. Për të konkluduar në lidhje me pikën e parë, rezulton se deri para ndryshimeve ligjore të v. 2020, nuk ka ekzistuar një sistem informatik që të shmangte çdo mundësi gabimi apo padijenje në raport me verifikimin e ekzistencës së një subjekti tregëtues me status *joaktiv*. Ekzistenca e një *file* në faqen e DPT-së për të cilën fillimisht (për periudhën deri në v.2019) parashikohej *përditësimi nga DPT* (pa normim mbi shpeshësinë e këtij procesi), e pas vitit 2019 *përditësimi i përditshëm nga DPT-ja*, në raport kjo me dinamikën që ka normalisht një subjekt tregëtar, apo operacioneve që ai duhet të kryejë, çmon se nuk provon dijeninë e të pandehurit jashtë çdo dyshimi, mbi verifikimin e statusit të subjektit blerës.

18.4. Në lidhje me elementin e dytë të anës subjektive, mbi mungesën e aktivitetit të subjektit tregëtar blerës, nga provat e shqyrtuara, pjesë e dosjes së gjyqimit, rezultoi e provuar se nga ana e administratës tatimore, janë kryer verifikime vetëm në lidhje me ankesën e subjektit ‘Lindita Spaho’ pf, ndërkohë që nuk u soll asnjë akt verifikimi, vlerësimi, hetimi apo kontrolli përkundrejt asnjë prej subjekteve të tjerë për të cilët të pandehurit rezulton të kenë lëshuar dhe deklaruar rregullisht në sistemin tatimor faturat përkatëse. Kjo mungesë e verifikimit në raport me subjektet blerëse, paçka *pasivitetit* që rezulton në statusin e tyre ligjor, nuk provon tej çdo dyshimi mundësinë e ushtrimit faktik të aktivitetit tregëtar prej tyre. Kjo mungesë verifikimi, në vlerësimin e gjykatës, përpos sanksionit administrativ që ligji i ngarkon shitësit/të pandehurit në këtë gjykim, për mos-verifikim statusi, nuk mund t’i atribuohet si e metë këtij të fundit dhe as nuk çmohet se sjell përgjegjësi penale në ngarkim të tyre.

18.5. Në lidhje me elementin e tretë që konfiguron në tërësi anën subjektive të veprës penale konkrete, Gjykata çmon të arsyetojë se, cili ka qenë detyrimi ligjor i të pandehurit në raport me veprimet e kryera prej tij dhe pasoja që ligji ju njuh këtyre veprimeve. Sikurse ka rezultuar nga hetimi, qoftë administrata tatimore ashtu edhe organi i akuzës nuk shfaq pretendime në lidhje me mos-deklarimin apo mos-regjistrimin e faturave në regjistrat tatimore të verifikueshme në çdo moment prej këtyre të fundit, dhe as të mungonte evidentimi i tyre në librat e shitjes/blerjes. Përkundrazi, deklarimi i faturave, ka sjellë si rrjedhojë përlllogaritjen e detyrimeve tatimore që lindin nga qarkullimi tregëtar i subjekteve të pandehura. Gjithashtu, në mungesën e një verifikimi në vend sikurse ligji ngarkon administratën tatimore, nuk u administrua në dobi të këtij gjykimi ndonjë akt ekspertimi që të hidhte dritë edhe përsa i përket faturave tatimore të lëshuara për periudhën Qershor 2016 - 2020.

18.6. Në konkluzion edhe të këtij elementi të tretë që konfiguron veprën penale të pretenduar të konsumuar nga organi i akuzës, Gjykata çmon të theksojë se, veprimet e rezultuara të kryera nga të pandehurit : Alban Ujkashej, Dritan Bylyku, Ana Zervoi, Roland Joti, Ylli Shemeti, Florent Venediku, “Inter Distribution Services” shpk dhe “Inter Trade & Distribution” shpk, ju mungon ana subjektive si një element i domosdoshëm i konsumimit të veprës penale.

19. Deri me ndryshimet e sjella me paketën fiskale të v.2020, ligji nuk parashikonte shprehimisht detyrimet dhe pasojat që rezultonin ndaj një tatimpaguesi për mos-verifikim në kohë reale të

statusit të një blerësi. Pasojat e para ligjore u parashikuan me ndryshimet e vitit 2019, që gjithsesi, qëndronin në kufijtë e sanksionit administrativ, sipas nenit 128 të Ligjit “Për procedurat tatimore ne RSH”. Gjithashtu, me rëndësi çmohet të evidentohet edhe detyrimi që ligji i ngarkonte DPT-së për përditësimin e *databazës*, i cili objektivisht nuk i përgjigjej nevojave operative që normalisht ka një subjekt ekonomik në treg.

19.1. Duke analizuar këto dy situata ligjore dhe faktike të kohës, në raport me aktet dhe provat e sjella në gjykim, për asnjë moment nuk u verifikua dhe as u provua qoftë dijenia e të pandehurve në raport me statusin juridik të blerësve *joaktivë* dhe as u përmbush barra e provës nga organi i akuzës për të provuar mos-ushtrimin faktik të këtyre subjekteve të një aktiviteti tregëtar. Kjo gjendje e paprovuar fakti, e shtyn gjykatën që vlerësimin në tërësi të ekzistencës së anës subjektive si thelbësore për cilësimin juridik të veprës penale të “Fshehja e të ardhurave”, të parashikuar nga neni 180 i K.Penal, ta çmojë në favor të pozitës juridike të të pandehurit, konform përcaktimit të nenit 4 të k.,Pr.Penale.

20. Në konkluzion të pikës 1, të çështjes ligjore të shtruar për trajtim, Gjykata arrin në përfundimin se, pasaktësia në raport me plotësimin formal të faturave tatimore, përsa i përket statusit juridik të subjekteve blerëse, nuk parashikohet nga ligji si vepër penale, por qëndron në kufijtë e një kundërvajtje administrative, për të cilën ligji për procedurat tatimore, parashikon sanksion me gjobë ndaj subjektit tregëtar konkret, Përpos kësaj, nga gjykimi i zhvilluar në bazë të provave të administruara dhe sjella nga prokuroria, nuk arrin të provohet konsumimi i anës subjektive të veprës penale të “Fshehja e të ardhurave”, e parashikuar nga neni 180/1 i K.Penal, e për këtë arsye, të pandehurit: Alban Ujkashej, Dritan Bylyku, Ana Zervoi, Roland Joti, Ylli Shemeti, Florent Venediku, “Inter Distribution Services” shpk dhe “Inter Trade & Distribution” shpk, duhet të deklarohen të pafajshëm në bazë të nenit 388, pika 1, gërma ‘b’ dhe ‘d’ të K.Pr.Penale.

21. Në lidhje me çështjen e dytë të shtruar për diskutim nëse: *Pasaktësitë e konstatuara në faturat e lëshuara nga ana e subjekteve tregëtare IDS dhe ITD shpk, a përmbushin elementët e veprës penale të falsifikimi i dokumentave, të parashikuar nga neni 186 i K.Penal*, Gjykata arsyeton se:

21.1. Falsifikimi i dokumentave (faturave) në rastin konkret, sipas doktrinës së të drejtës penale dhe jurisprudencës gjyqësore, konsumohet përmes dy mënyrave : i) përmes falsifikimit mekanik të aktit, që konsiston në ndryshimet mekanike të të dhënave që pasqyrohen në përmbajtjen e aktit (përmes korigjimeve apo ndryshimeve në të dhënat e tij); ose ii) përmes falsifikimit intelektual, apo i shprehur ndryshe si paraqitja e të dhënave që nuk përputhen me gjendjen reale përmbajtëseore të aktit.

21.2. Në rastin konkret, përsa ka rezultuar nga aktet e sjella në gjykim, të çmuara sipas rritit të gjykimit të shkurtuar, gjykata vlerëson se, në lidhje me mënyrën e parë të konsumimit të kësaj vepre penale - përveç faturave të lëshuara ndaj subjektit ‘Lindita Spaho’ pf, analiza e të cilave ngrihet dhe trajtohet në çështjen ligjore të mëposhtme – rezulton se nga prokuroria nuk është urdhëruar dhe as administruar ndonjë akt shkencor grafik shkrimi, sipas të cilit të verifikohet dhe provohet nëse në faturat e redaktuara dhe deklaruara rregullisht nga subjektet e pandehura, të jenë kryer ndryshime, korigjime apo nënshkrime të cilat nuk ju përkasin personave kompetentë, të cilët e kanë lëshuar apo ju drejtohen këto akte (fatura). Në mungesë të një akti të tillë që do të hidhte dritë mbi rregullshmërinë e faturave, nuk rezulton asnjë rrethanë që të deklarojë e aq më pak të

provojë të kundërtën e atyre çka ato dëshmojnë dhe janë verifikuar nga administrata tatimore në vijimësi.

21.3. Në lidhje me mënyrën e dytë të konsumimit të falsifikimit të dokumentave, Gjykata mban ndër të tjera në konsideratë dy momente : i) së pari konkluzionin e arritur në çështjen e parë ligjore, në përfundim të së cilës u çmua se pasaktësitë mbi statusin e blerësit, nuk passjellin përgjegjësi penale sipas ligjit; ii) dhe së dyti, mban në konsideratë faktin se, faturat e subjekteve IDS dhe ITD shpk, rezultojnë të jenë deklaruar sipas afateve ligjore në librat e shitjes/blerjes, janë verifikuar nga administrata tatimore e mbi bazën e tyre, rezultojnë të jenë përlllogaritur e paguar detyrimet. Në mënyrë të njëjtë sikurse analiza e bërë edhe më sipër, mos-verifikimi i statusit të blerësit, nuk paraqet të metë në drejtim të sjelljes së pasojave ligjore dhe financiare të faturave të lëshuara. Pasi përmbajtja e pasqyruar në fatura, nuk provohet të mos i referohen një situatë reale, përse kohë që nuk rezultojnë asnjë provë që të dëshmojë qoftë mungesën e furnizimit dhe as mos-likuidimin e detyrimit për furnizimin e realizuar. Duke mos u verifikuar asnjë e metë në këto dy elementë thelbësorë që kushtëzojnë vlefshmërinë përmbajtësore të një fature, e çojnë Gjykatën drejt konkluzionit se, përkundrejt faturave të lëshuara në periudhën maj 2016 – 2020, përpos pasaktësive në raport me statusin e blerësit të tyre, ato kanë sjellë të gjitha efektet e tjera të parashikuara dhe të pritshme ndërmjet subjekteve tregëtare. Ligji e parashikon eventualitetin e natyrës së pasaktësisë ndaj statusit të një subjekti tregëtar palë e faturës, duke parashikuar edhe sanksionin përkatës, por në asnjë rast ky i fundit (ligji), nuk e parashikon atë si të pavlefshme apo të falsifikuar në tërësinë e saj. Përpos kësaj, në një analizë të fundit, pavarësisht statusit që kanë palët ligjërisht, faturat qoftë formalisht ashtu edhe përmbajtësisht nuk kanë asnjë të metë, përse kohë nuk është verifikuar asnjë rrethanë që të dëshmojë deficienca në ndonjë nga elementët thelbësorë (data e lëshimit, sasia e mallit të lëvruar; çmimi i mallit të furnizuar; emrat e subjeteve tregëtare; niptet e subjekteve tregëtare; nënshkrimet e palëve etj).

21.4. Në konkluzion edhe të çështjes së dytë ligjore të ngritur për trajtim, Gjykata çmon se nuk verifikohet dhe as provohet ekzistenca e faturave me përmbajtje të falsifikuar në kuptim të nenit 186 të K.Penal. Pasaktësitë e verifikuara në lidhje me statusin e blerësve, ligji ju njeh sanksionin përkatës, i cili gjithsesi mbetet në kufijtë e masës administrative për të cilat subjektet e pandehura janë përgjegjëse, por që në kuptimin penal, kjo pasaktësi nuk konfigurohet si veprë penale. Vepra penale e falsifikimit të dokumentave e pretenduar në rastin konkret nga organi i akuzës, pavarësisht analizës së bërë më sipër, mund të kuptohet vetëm si element i anës objektive të veprës penale të “Fshehja e të ardhurave” të parashikuar nga neni 180 i K.Penal. Duke konkluduar se, pasaktësia në lidhje me subjektet pasivë, nuk konsiderohet si mpleksëse e ligjit penal, duke mbetur në kufijtë e kundërvajtjes administrative, e për pasojë duke mos patur konsum të veprës kryesore të pretenduar në këtë rast, gjykata çmon se çështja penale përse i përket akuzës së “Falsifikimi i dokumentave”, parashikuar nga neni 186/2 i K.Penal, nuk duhet të fillohet, e në gjendjen kur për të janë marrë të pandehur shtetasit : Alban Ujkashej, Dritan Bylyku, Ana Zervoi, Roland Joti, Ylli Shemeti, Florent Venediku, “Inter Distribution Services” shpk dhe “Inter Trade & Distribution” shpk, përse i përket faktit penal që lidhet me faturat e lëshuara për periudhën maj 2016 - 2020, ajo duhet të pushojë në kuptim të nenit 387/1, dhe 328/1, gërma ‘b’ dhe ‘d’ të K.Pr.Penale.

22. Në lidhje me çështjen e tretë ligjore të shtruar për diskutim se: *Faturat tatimore të falsifikuara, të konstatuara nga akti i ekspertimit grafik shkrimi, cilës periudhë i përkasin dhe si qëndron raporti i tyre me nenin 66 të K.Penal*, gjykata çmon të arsyetojë se :

22.1. Ndryshe nga sa ka rezultuar me subjektet blerëse - për të cilat as nga organet tatimore dhe as nga hetimet e prokurorisë, nuk u provua aktiviteti faktik i subjekteve, e rrjedhimisht as ana

subjektive e të pandehurve si element i nevojshëm për të qenë përpara nenit 180/1 të K.Penal – situata paraqitet e ndryshme përse i përket hetimeve dhe konkluzioneve të arritura në lidhje me veprën penale të “Falsifikimi i dokumentave”, e parashikuar dhe e dënueshme nga neni 186 i Kodit Penal, përse i përket faktit që lidhet me lëshimin e faturave tatimore të periudhës janar 2015 - maj 2016 në favor të subjektit tatimpagues ‘Lindita Spaho’ pf.

22.2. Sikurse ka rezultuar nga hetimi, faturat e cituara numerikisht dhe të lëshuara nga subjektet tregëtare të pandehura, ndaj shtetases Lindita Spaho, si administratore e subjektit me të njëjtën emër person fizik, përmbanin në rekuizitën e ‘blerësit’, nënshkrime të cilat në një pjesë të faturave të evidenuara nuk kanë qenë të kësaj shtetaseje, e për rrjedhojë nënshkrimi në to është i falsifikuar. Sikurse ka rezultuar edhe nga vetë deklaratimet e të pandehurve Ana Zervoi dhe Eduart Alushi, ka qenë ky i fundit në cilësinë e punëmarrësit, që kishte lëshuar faturat ndaj subjektit ‘Lindita Spaho’ pf, megjithëse ato ishin në një vlerë më të madhe sesa furnizimi real i mallrave.

23. “Falsifikimi i dokumentave”, e parashikuar dhe e dënueshme nga neni 186/2 të K.Penal, parashikon se *“Falsifikimi ose përdorimi i dokumentave të falsifikuara dënohet me burgim deri në tre vjet. Kur kjo veprë kryhet në bashkëpunim ose më shumë se një herë apo ka sjellë pasojë të rëndë, dënohet me burgim nga gjashtë muaj deri në katër vjet....”*

23.1. Në rastin konkret, duke ju referuar personit i cili ka lëshuar dhe nënshkruar faturat tatimore ndaj subjektit ‘Lindita Spaho’ pf, ku në disa raste nënshkrimi i kësaj të fundit ka qenë i falsifikuar, rrjedhimisht e ngarkon me përgjegjësi penale shtetasn Eduart Alushi konform dispozitës penale të nenit 186/1 të K.Penal.

23.2. Kjo veprë ana objektive është kryer përmes nënshkrimit në mënyrë të parregullt në emër të blerëses faturat tatimore, duke sjellë krijimin e detyrimeve të paqena në ngarkim të saj. Pavarësisht se nuk verifikohet dhe provohet interesi i të pandehurit, dispozita në fjalë përbën një veprë penale formale, për të cilën nuk rezulton e nevojshme ardhja e pasojës për ta cilësuar si krim.

23.4. Falsiteti në lidhje me nënshkrimin në faturat tatimore të lëshuara nga Eduart Alushi ndaj subjektit ‘Lindita Spaho’ pf, provohet nga administrimi i aktit të ekspertimit grafik nr. 4716, datë 19.05.2021 dhënë nga Instituti i Policisë Shkencore, në konkluzion të të cilit ndër të tjera arrihet në përfundimin se : *“Shkrimet emër mbiemër “Lindita Spaho”, dhe nënshkrimet (firmat) përkatëse objekte të dpd eksperimi....nuk duhet të jenë nënshkruar nga shtetësja Lindita Spaho”*. Përpos këtij konkluzioni, gjykata mban në konsideratë edhe deklaratimet e bëra nga ana e shtetases Lindita Spaho, si edhe nga pranimit i është bërë këtij fakti nga i pandehuri Eduart Alushi, deklaratimet e të cilëve janë administruar e çmuar në cilësinë e provës në gjykim.

24. Në konkluzion të pikës së parë, të çështjes së tretë ligjore të ngritur për diskutim, arrihet në përfundimin se, faturat e dyshuara të falsifikuara, nga provat e marra dhe shqyrtuara në gjykim, provohet se janë të falsifikuara dhe për to përgjegjësi penale rëndon ndaj të pandehurit Eduart Alushi. Gjithashtu nga kqyrja e faturave objekt eksperimit, konkludohet se ato i përkasin periudhës së lëshimit Janar 2015 – Maj 2016.

25. Së fundmi, në lidhje me pikën e fundit të çështjes së tretë ligjore të ngritur për trajtim, Gjykata çmon të analizojë nëse është plotësuar afati i parashkrimit të ndjekjes penale, përse i përket të pandehurit të sipërcituar, në kuptim të nenit 66 të K.Penal.

25.1. Në bazë të nenit 66 të Kodit Penal (ndryshuar me ligjin nr. 36/2017, datë 30.03.2017), parashikohet se “Nuk mund të bëhen ndjekje penale kur nga kryerja e veprës penale deri në çastin e marrjes së personit si të pandehur kanë kaluar : a)....; b)....ç) pesë vjet për krimet që parashikojnë dënim gjer në pesë vjet burgim ose gjobë;”.

25.2. Nga fashikulli i hetimit, rezulton se prokurori ka disponuar me regjistrimin e emrit të autorëve në datën 28.12.2021, ndërkohë që edhe akti i njoftimit të akuzës dhe marrjes së personave të pandehur, mban gjithashtu datën 28.12.2021. Nga ana tjetër, rezulton se faturat e provuara të falsifikuara i përkasin periudhës Janar 2015 – Maj 2016. Duke mbajtur në konsideratë këto momente fakti, në raport me sanksion e nenit 66 të K.Penal, rezulton se i pandehuri në lidhje me lëshimin e faturave tatimore të kësaj periudhe, do të vendosej përpara përgjegjësisë dhe do të deklarohet i fajshëm, vetëm nëse do ti njoftohej akuza dhe merrej i pandehur, maksimalisht deri në maj të vitit 2021, pas kësaj periudhe rezulton se ndjekja penale ndaj tij është shuar, e për këtë arsye kjo vepër/akuzë duhet pushuar.

26. Në konkluzion të çështjes së tretë të ngritur për diskutim, arrihet në konkluzionin ligjor se, për veprën penale të “Falsifikimi i dokumentave”, e parashikuar dhe e dënueshme nga neni 186 i K.Penal, në ngarkim të të pandehurit Eduart Allushi, ndodhemi përpara një rrethane, që e ka shuar veprën penale, e për pasojë e bën të pamundur vijimin e procesit penal dhe dënimin e këtij personi, konform nenit 328, pika 1, gërma ‘d’, në lidhje me nenin 387 pika 1 të K.Pr.Penale.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata, në bazë të neneve 328/1, 387/1, 388/1, gërma ‘c’ dhe 405 e vijues të K.Pr.Penale,

VENDOSI:

1. Deklarimin e pafajshëm të të pandehurve : Alban Ujkashej, Dritan Bylyku, Ana Zervoi, Roland Joti, Ylli Shemeti, Florent Venediku , “Inter Trade & Distribution” shpk dhe “Inter Distribution Services”, për veprën penale të “Fshehja e të ardhurave”, të parashikuar nga neni 180/1 i K.Penal.
2. Pushimin e çështjes përse i përket akuzës së: “Falsifikimi i dokumentave”, e kryer në bashkëpunim, e parashikuar nga neni 186/2 i K.Penal, për të cilën ishin marrë të pandehur shtetasit/subjektet: Alban Ujkashej, Dritan Bylyku, Ana Zervoi, Roland Joti, Ylli Shemeti, Florent Venediku “Inter Trade & Distribution” shpk, “Inter Distribution Services” shpk dhe Eduart Allushi.
3. Shpenzime e kryera gjatë hetimeve paraprake dhe ato të gjykimit, mbeten në ngarkim të shtetit.
4. Kunder vendimit lejohet ankim brenda 15 (pesëmbëdhjete) diteve nga dita e njoftimit të ketij vendimi në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

U shpall sot në Tiranë më datë 29.05.2023 ora 14.20.

**SEKRETARE
GENTIANA SADIKU**

**GJYQTARE
VJOLLCA SPAHIU**